



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, datë 23.01.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Pranimin e propozimit për autorizimin e administratës së AMA-s për vlerësimin e impaktit në strategjinë e migrimit të DD2 dhe të kostove të procesit të kompensimit. **(Vendim nr. 8, datë 23.01.2026)**
2. Rialokimin e zërave të Projektbuxhetit për vitin 2026. **(Vendim nr. 9, datë 23.01.2026)**
3. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Korabi-Net” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Korabi-Net”. **(Vendim nr. 10, datë 23.01.2026)**
4. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë të shoqërisë “Tring TV” sh.a., autorizuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv dhe përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor, dhe për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve online, mbështetur në rrjet IP (OTT) “Tring TV”. **(Vendim nr. 11, datë 23.01.2026)**
5. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Tele.Co.Albania” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tele.Co.Albania”. **(Vendim nr. 12, datë 23.01.2026)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 23 Janar 2026